



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2685/10 prot.

Datë 07.11.2025

V E N D I M
Nr.1621/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.11.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të KPP nr. 1491/2025, datë 21.10.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-56502-07-29-2025, me objekt: “Blerje Gazkromatograf Bidimensional për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave”, me fond limit 16,956,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 29.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara..

Ankimues:

Operatori ekonomik “Pegasus” SHPK,, me NIPT J62903750A dhe adresë: Rruga Siri Kodra, tek ish frigoriferi, Nr. 149, Tiranë.

Operatori ekonomik “Krijon” SHPK me NIPT K12023001A dhe adresë: Rruga e Elbasanit, nr.57, Collak, 1044, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara me adresë Rr. “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datën 21.10.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.1491/2025 ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-56502-07-29-2025, me objekt: “Blerje Gazkromatograf Bidimensional për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave”, me fond limit 16,956,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 29.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.*
2. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Krijon” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.*
3. *Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorëve ekonomikë “Pegasus” SHPK dhe “Krijon” SHPK dhe të korigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.*
4. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
5. *Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “Pegasus” SHPK dhe “Krijon” SHPK.*
6. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
7. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

I.2. Me shkresën nr. 2364/12 prot., datë 03.11.2025 protokolluar me tonën nr. 2685/7 prot., datë 05.11.2025 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.1491/2025 datë 21.10.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-56502-07-29-2025, me objekt: “Blerje Gazkromatograf Bidimensional për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave”, me fond limit 16,956,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 29.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1 Me shkresën nr. 2364/12 prot., datë 03.11.2025 protokolluar me tonën nr. 2685/7 prot., datë 05.11.2025 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.1491/2025 datë 21.10.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-56502-07-29-2025, me objekt: “Blerje Gazkromatograf Bidimensional për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave”, me fond limit 16,956,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 29.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.1491/2025 datë 21.10.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim rezultoi se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të procedurës object ankimi, në zbatim të vendimit Nr.1491/2025 datë 21.10.2025, të këtij komisioni.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-56502-07-29-2025, me objekt: “Blerje Gazkromatograf Bidimensional për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave”, me fond limit 16,956,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 29.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

